

VENDIM
Nr. 61, datë 23.1.2013

PËR MIRATIMIN E KALIMIT NË PRONËSI TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE
INFORMALE TË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, përkatësisht për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1, 39 (tridhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 10 415,3 (dhjetë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë presje tre) m²;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2, 14 (katërmëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 729 (pesë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) m²;

c) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 3, 40 (dyzet) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 059,47 (dy mijë e pesëdhjetë e nëntë presje dyzet e shtatë) m²;

ç) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, 13 (trembëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 775,09 (tri mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë presje zero nëntë) m²;

d) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 47 (dyzet e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 443 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e tre) m²;

dh) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlora 1, 92 (nëntëdhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 32 708 (tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë) m²;

e) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlora 2, 86 (tetëdhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 31 680 (tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) m²;

ë) Drejtorinë e ALUIZNI-t Sarandë, 212 (dyqind e dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 85 734,5 (tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër presje pesë) m²;

f) Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, 59 (pesëdhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 13 230,81 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë presje tetëdhjetë e një) m²;

g) Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër, 99 (nëntëdhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 986,56 (pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje pesëdhjetë e gjashtë) m²;

gj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier 1, 15 (pesëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 168,9 (katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje nëntë) m²;

h) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier 2, 231 (dyqind e tridhjetë e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 83 993,2 (tetëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tri presje dy) m²;

i) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lushnjë, 70 (shtatëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 329,89 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e nëntë presje tetëdhjetë e nëntë) m²;

j) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan 1, 33 (tridhjetë e tri) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 473,7 (gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tri presje shtatë) m²;

k) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan 2, 36 (tridhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 483,2 (nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tri presje dy) m²;

l) Drejtorinë e ALUIZNI-t Dibër, 20 (njëzet) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme

trualli 1 464,71 (një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e një) m²;

ll) Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastrë, 13 (trembëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 512,1 (pesëqind e dymbëdhjetë presje një) m²;

m) Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë, 3 (tri) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 491,1 (katërqind e nëntëdhjetë e një presje një) m²;

n) Drejtorinë e ALUIZNI-t Pogradec, 3 (tri) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 870 (tetëqind e shtatëdhjetë) m²;

nj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Krujë, 122 (njëqind e njëzet e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 33 098,8 (tridhjetë e tri mijë e nëntëdhjetë e tetë presje tetë) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha